

Në këtë periodik do të lexoni:

AMF zgjeron bashkëpunimin me rregullatorët evropianë, nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Bankën Kombëtare të Hungarisë

**Tregu i sigurimeve, janar-tetor 2024
Zhvillimet e tregut të pensioneve private, janar - shtator 2024**

VËSHTRIM MBI TREGJET

**ZHVILLIME TË TJERA
BOTIME PROFESIONALE**

6-11

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

12-14

AMF zgjeron bashkëpunimin me rregullatorët evropianë, nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Bankën Kombëtare të Hungarisë



Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve financiarë në fushat ku ata ushtrojnë funksionet mbikëqyrëse, me fokus kryesor tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Banka Kombëtare e Hungarisë (MNB) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi, në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy rregullatorëve.

Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, znj. Mimoza Kaçi dhe Zv.Guvernatori i Bankës Kombëtare të Hungarisë, z. Csaba Kandrács.

Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve financiarë, në fushat ku ata ushtrojnë funksionet mbikëqyrëse, me fokus kryesor tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Memorandumi i Mirëkuptimit vendos ura bashkëpunimi mes dy autoriteteve mbikëqyrëse, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, si edhe promovimit të integritetit, stabilitetit dhe eficiencës në tregjet nën mbikëqyrje.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit vjen pak ditë pasi Shqipëria hapi zyrtarisht gjatë presidencës hungareze negociatat me BE-në për grupkapitujt e Themelorëve. Autoriteti është institucioni drejtues i kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, si edhe jep kontributin e tij për një sërë kapitujsh në procesin e negociatave.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – tetor 2024


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar - tetor 2024 kapën vlerën 20,262 milionë lekë, ose 7.56% më shumë se në janar - tetor 2023. Gjatë muajit janar - tetor 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,316,983 me një rritje prej 8.66% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.89% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.07% dhe risigurimi me 0.035% . Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.25% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.75% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar - tetor 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 7,044 milionë lekë, ose 22.75% më shumë se në periudhën janar - tetor 2023.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar - tetor 2024 kapën vlerën 5,188 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 30.69% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar – tetor 2024 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar - tetor 2024 arritën rreth 12,308 milionë lekë, ose 7.90 % më shumë se në periudhën janar - tetor 2023.


Zhvillimet e tregut të pensioneve private, janar – shtator 2024

Gjatë periudhës janar-shtator 2024, në tregun e fondeve të pensioneve private ushtruan aktivitetin e tyre gjashtë fonde pensioni.

Analiza e të dhënave për tregun e fondeve të pensioneve private më 30.09.2024 tregon një total asetesh neto prej 7,745.89 milionë lekë ose rreth 78.42 milionë euro. (Sipas kursit zyrtar të këmbimit nga Banka e Shqipërisë 1 euro = 98.77 lekë.) Kjo vlerë e asetëve neto shpreh një rritje prej 1,008 milionë lekë ose rreth 14.96% me shumë krahasuar me 31.12.2023.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve private, më 30.09.2024 ishte 43,375 anëtarë, duke shënuar një rritje prej 13.61% krahasuar me 31.12.2023.

Vlera e asetëve neto të fondeve të pensioneve private, 30.09.2024 (Në %)



Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve private, më 30.09.2024 u rrit me 13.61% krahasuar me 31.12.2023.

ZHVILLIME TË TJERA

Trajnim i studentëve për “Lojën virtuale në bursë” Stock Market Learning Competition

AKTORET E TREGUT TE KAPITALEVE

Eshte tregu qe i permbledh te gjithe aktorët ne nje vend duke u mundesuar:

- emetuesve rritje kapitali,
- investitoreve mundesi investimi,
- brokerve kushte ndermjetesime.
- pa-anshmeri dhe transparence
- mbikeqyrje dhe integritet

Mbrojtja e interesave të investitorëve ↔ **Zhvillimi i industrisë**

Mesatare e Artë

Mbikëqyrje e procesit ↔ **Licënsim**

German Sparkassenstiftung FOR INTERNATIONAL COOPERATION
20.11.2024
DSK Albania- Stock Market Learning 6


Synimi i kësaj loje virtuale në bursë është dhënia e sa më shumë informacione studentëve, që ata të kuptojmë më mirë si funksionojnë tregjet e kapitalit.

Në vijimësi të projektit “Të mësojmë për bursën” me datë 20 nëntor 2024 u zhvillua trajnimi online, me studentët dhe skuadrat pjesëmarrëse në lojën virtuale në bursë. Aktiviteti u organizua nga organizata gjermane “German Sparkassenstiftung Albania” si edhe me mbështetjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Në këtë konkurs ndërkombëtar të njohur si “Stock Market Learning Competition”, marrin pjesë edhe 23 skuadra me studentë shqiptarë nga 15 universitete publike dhe private në vend. Ky është viti i katërt që studentët shqiptarë përfshihen në këtë platformë virtuale tregtimi online të titujve të kapitalit. Synimi i kësaj loje virtuale në bursë është dhënia e sa më shumë informacioneve të studentët, që ata të kuptojmë më mirë si funksionojnë tregjet e kapitalit.

Trajneri, z. Artan Gjergji prezantoi për studentët konceptet themelore të tregjeve të kapitalit, klasifikimin e tyre, aktorët kryesore në këto tregje, rolin e mbikëqyrësit, rregullatorit siç është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Ai e vuri theksin te procesi i investimit dhe ndërtimit të portofolit si investitor, duke i këshilluar skuadrat e studentëve se çfarë duhet të kenë parasysh kur ndërtojnë portofolin e tyre të investimit dhe si mund të mbrohen nga risku në këtë loje investimi.

Vijon ...

Trajnim i studentëve për “Lojën virtuale në bursë” Stock Market Learning Competition



... vijon

Që prej muajit tetor, skuadrat e studentëve kanë hyrë në platformën virtuale të bursës, janë pajisur me fonde virtuale dhe po investojnë në tituj financiarë. Ata po kryejnë transaksione me portofolat e tyre të investimit, sipas strategjive të ndryshme të investimeve që ata kanë përzgjedhur. Loja virtuale në bursë do të përfundojë në fund të janarin 2025. Skuadrat vlerësohen si për treguesin e performancës në tregje, ashtu edhe për atë të qëndrueshmërisë së transaksioneve financiare.

Në shkurt 2025, një juri e pavarur ndërkombëtare do të vlerësojë portofolat e investimeve për secilën skuadër, dhe vlerësojë me çmime përkatëse, sipas këtyre dy kategorive.



IAIS publikon materiale mbështetëse në funksion të mbikëqyrjes në sigurime

<https://www.iaisweb.org/publications/application-papers/>

Gjatë muajit nëntor 2024 IAIS ka publikuar dy dokumente “Application Papers” të cilat ofrojnë informacione mbështetëse lidhur me materiale të veçanta mbikëqyrëse siç janë Parimet Bazë të Sigurimeve apo Kuadri i Përbashkët (ICP ose ComFrame).

- ❑ Dokument (*Application Paper*) mbi mbikëqyrjen e DEI - perspektiva e qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe kulturës;
[Application paper on supervising DEI – the governance, risk management and culture perspective](#)
- ❑ Draft dokument (*Application Paper*) për mbikëqyrjen e Inteligjencës artificiale.

[Draft Application Paper on the supervision of artificial intelligence](#)

IAIS publikon materiale mbështetëse në funksion të mbikëqyrjes së Inteligjencës Artificiale në sigurime

<https://www.iaisweb.org/publications/application-papers/>

Më 18 nëntor 2024, IAIS publikoi dokumentin “Application Papers” mbi mbikëqyrjen e Inteligjencës Artificiale (IA). Ky dokument jep një tërësi informacioni lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale në sigurime. Ai trajton tematika që lidhen me qeverisjen dhe llogaridhënien, sigurinë, transparencën, drejtësinë dhe çështjet e lidhura me etikën dhe korrigjimin, menaxhimin e të dhënave në kontekstin e drejtë, monitorimin e rezultateve të sistemeve IA si edhe ndikimet shoqërore.

Në fund, dokumenti prezanton rastet dhe praktikatat më të mira nga vendet anëtare të IAIS, si nga vendet e Bashkimit Evropian, Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve (NAIC) e SHBA, Britania e Madhe, Singapori, etj.

Përmbledhje Ekzekutive

Miratimi i sistemeve të inteligjencës artificiale, IA po përshpejtohet globalisht. Për siguruesit, këto zhvillime ofrojnë përfitime të konsiderueshme tregtare në të gjithë zinxhirin e vlerës së sigurimit, si duke arritur reduktime të konsiderueshme të kostove nëpërmjet rritjes së efikasitetit në administrimin e policave dhe menaxhimin e dëmeve, ose duke aplikuar aftësitë IA për të përmirësuar përzgjedhjen e rrezikut dhe çmimin.

Megjithatë, me këto avancime vijnë edhe rreziqe të dukshme që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin financiar të siguruesve dhe të konsumatorëve. Për shembull, nëse nuk kontrollohen, sistemet IA mund të përforcojnë paragjykimet historike shoqërore ose diskriminimin dhe, për individët, mund të rrisin shqetësimet rreth privatësisë së të dhënave. Për siguruesit, natyra e errët dhe komplekse e disa sistemeve IA mund të çojë në çështje të llogaridhënies, ku bëhet e vështirë të gjurmohen vendimet ose veprimet tek operatorët njerëzorë dhe pasiguria e rezultateve (veçanërisht në një mjedis të jashtëm në ndryshim). Adresimi i shqetësimeve të tilla është thelbësor për ruajtjen e besimit dhe drejtësisë në industri.

Vijon...



Materiali i diskutimit për
Inteligjencën Artificiale
gjendet në:

[Draft Application Paper on the
supervision of artificial
intelligence](#)

IAIS publikon materiale mbështetëse në funksion të mbikëqyrjes së Inteligjencës Artificiale në sigurime

<https://www.iaisweb.org/publications/application-papers/>

... Vijon

Puna e mëparshme e bërë nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) ka pohuar se Parimet Themelore të Sigurimeve (ICP) vazhdojnë të jenë të përshtatshme dhe të rëndësishme në menaxhimin e këtyre rreziqeve. Prandaj, objektivi i këtij dokumenti të aplikimit është të mbështesë mbikëqyrësit kur aplikojnë ICP-të për të promovuar mbikëqyrjen e duhur dhe të qëndrueshme globalisht gjatë përdorimit të IA brenda sektorit të sigurimeve.

Ky Dokument Aplikimi përforcon rëndësinë e ICP-ve, duke nënvizuar se si pritshmëritë ekzistuese rreth qeverisjes dhe sjelljes mbeten konsiderata thelbësore për mbikëqyrësit dhe siguruesit që përdorin IA. Për më tepër, duke vënë në dukje se IA mund të amplifikojë rreziqet ekzistuese, ky dokument thekson rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm të bordit dhe menaxherëve të lartë, në mënyrë që të vendosen korniza të fuqishme të rrezikut dhe qeverisjes për të siguruar rezultate të mira për konsumatorët. Për më tepër, ky dokument vëren se aplikimi në rritje i IA mund të rrisë rolin e palëve të treta si shitësit e modeleve të IA. Në përputhje me ICP-të ekzistuese, ky dokument ripohon se siguruesit mbeten përgjegjës për të kuptuar dhe menaxhuar këto sisteme dhe rezultatet e tyre.


Vijon ...



Materiali i diskutimit për
Inteligjencën Artificiale
gjendet në:

[Draft Application Paper on the supervision of artificial intelligence](#)

Figure 1: Artificial intelligence and its different elements



IAIS publikon materiale mbështetëse në funksion të mbikëqyrjes së Inteligjencës Artificiale në sigurime

<https://www.iaisweb.org/publications/application-papers/>

... Vijon

Dokumentet e Aplikimit nuk vendosin standarde apo pritshmëri, por në vend të kësaj ofrojnë udhëzime shtesë për të ndihmuar zbatimin dhe për të ofruar shembuj të praktikës së mirë. Ky dokument fokusohet në ato kërkesa brenda ICP-ve ku sistemet mund të ndryshojnë natyrën e rrezikut përtej atyre të qenësishme në sistemet ekzistuese jo të Inteligjencës Artificiale. Për më tepër, ky dokument aplikimi pranon nevojën për të balancuar promovimin e inovacionit me minimizimin e rrezikut.

Ky dokument shfrytëzon punën e organizatave të tjera ndërkombëtare si Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ose Grupi i Njëzet (G20) për të siguruar një qasje konsistente ndaj IA në nivel ndërkombëtar duke marrë parasysh specifikat sektoriale. Duke pasur parasysh miratimin e shpejtë të pritshëm të IA në sektorin e sigurimeve, IAIS do të vazhdojë të monitorojë zhvillimet dhe do të përditësojë materialin sipas nevojës.



Materiali i diskutimit për
Inteligjencën Artificiale
gjendet në:

[Draft Application Paper on the
supervision of artificial
intelligence](#)

BOSNJE-HERCEGOVINA

www.xprimm.com

Sipas publikimit të agjencisë së sigurimeve në Bosnje-Hercegovine, AZOBIH, në fund të qershorit 2024, tregu i sigurimeve në BiH arriti në 279 milionë euro, duke shënuar një rritje 11.6% më shumë se një vit më parë. Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara nga siguresit u rrit me 7.74% në terma vjetorë, duke arritur në 110.16 milionë euro.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguresit që operojnë në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës u rrit me 11.5% duke arritur në 195.23 milionë euro. Kjo shifër përbën 70% të totalit të primeve të shkruara bruto. Ndërsa siguresit me bazë në Republikën Serbe të Bosnjës gjeneruan 83.76 milionë euro, duke u rritur me 11.96% në terma vjetore.

Krahasuar me gjashtëmujorin e vitit 2023, primet e sigurimit të Jo-Jetës në gjysmën e parë të këtij viti u rritën me 13.24%, ndërsa primet në segmentin e sigurimeve të Jetës u rritën me 5.24%. Nga nënklasat e Jo-Jetës, 25.69 milionë euro i korrespondojnë linjave të sigurimit të pronës dhe 166.22 milionë euro sigurimit motorik (MM dhe MTPL së bashku).

BULLGARIA

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikura nga autoriteti mbikëqyrës i tregut, në gjysmën e parë të 2024, siguresit bullgarë realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 1.19 miliardë euro, me rritje prej 3.3% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2023. Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës arriti në 203.5 milionë euro, ose 9% më shumë në terma vjetorë, ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës vëllimi i primeve arriti në 989.9 milionë euro, me rritje 2.7% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimi motorik vazhdon të zërë 58% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto në nivel tregu. Në gjysmën e parë të vitit, sigurimi motorik u rrit me 3% duke realizuar 700.7 milionë euro prime të shkruara bruto. Dy klasat brenda segmentit patën dinamika shumë të ndryshme: ndërsa klasa e sigurimit Kasko regjistroi një rritje të primeve bruto prej 16.3%, linja e sigurimit MTPL pati një rënie gati 5% të primeve.

KOSOVA

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, siguruesit në vend realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto, për tremujorin e tretë 2024, në vlerë prej 127.3 milionë euro duke shënuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 5.6 milionë euro nga 5.1 milionë euro që ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 14.9% në terma vjetorë duke arritur në 120.6 milionë euro. Ndër nënklasat më me ndikim në sigurimin e Jo-Jetës ishin sigurimi MTPL e brendshme që realizoi 66.6 milionë euro, policat kufitare që realizuan prime në vlerën e 6.6 milionë euro dhe 54 milionë euro u realizuan nga klasat e tjera të sigurimeve vullnetare.

SERBIA

www.xprimm.com

Sipas statistikave të gjashtëmujorit të publikuar nga Banka Kombëtare e Serbisë (NBS), siguruesit serbë e mbyllën gjysmën e parë të vitit 2024 me një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 759.86 milionë euro. Kjo shifër është 13.38% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu dominohet nga sigurimet e Jo-Jetës, të cilat gjenerojnë 82% të të gjitha primeve. Klasat më të mëdha të Jo-Jetës, me pjesë dyshifrore të tregut janë MTPL, dëmtime në pronë, sigurime shëndetësore, Sigurimi Kasko. Të gjitha këto shënuan rritje vjetore. Sigurimet e Jetës pësuan një rritje vjetore modeste, prej 8% dhe pesha e tyre në portofolin e tregut ra në 17.70%.

Totali i dëmeve të paguara u rrit me 15.88% duke arritur në 327.36 milionë euro, të nxitura nga rritjet e raportuara pothuajse në të gjitha nënklasat e sigurimeve të Jo-Jetës. Dëmet e paguara nga sigurimet motorike u rritën me gati 22%, ndërsa në sigurimin e pronës kompanitë paguan rreth 25% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

SLLOVAKIA

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të siguruar nga Shoqata Sllovaqe e Sigurimeve, SLASPO, vëllimi i primeve të shkruara nga siguruesit sllovakë arriti në 2.23 miliardë euro për nëntë-mujorin e 2024, që tregon një rritje me 9.57% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i Jetës përbën afër 37.3% të shumës totale të primeve të shkruara bruto prej 834.33 milionë euro me një rritje me 5.26% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja në sigurimet e Jo-Jetës ishte 12.47% në vit, dhe vëllimi i primeve arriti në 1.4 miliardë euro. Kontributin më të madh në rritjen e tregut e kanë linjat e sigurimit motorik dhe sigurimi i pronës.

SLOVENIA

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të siguruara nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, tregu slloven i sigurimeve ra me 10.8% në tremujorin e tretë 2024, duke arritur vlerën e primeve prej 2.09 miliardë euro. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 7.7%, duke arritur në 656.4 milionë euro, ndërsa primet në sigurimet e Jo-Jetës u ulën me 17.26%, në vlerën e 1.44 miliardë euro.

Rënia e madhe e segmentit të Jo-Jetës ishte rezultat i vendimit të qeverisë për të hequr, duke filluar nga 1 janari 2024 sigurimin shëndetësor suplementar vullnetar dhe për ta zëvendësuar atë me një kontribut të detyrueshëm shëndetësor të menaxhuar nga Instituti Publik i Sigurimeve shëndetësore të Sllovenisë. Të gjitha policat e lëshuara nga shoqëritë e sigurimit që ofrojnë sigurim shëndetësor suplementar skadojnë automatikisht në datën 31 dhjetor.

Klasa e sigurimeve shëndetësore pësoi një rënie prej 90.4% të vëllimit të primeve duke arritur në 49.6 milionë euro, dhe pesha e saj në portofolin e tregut u zvogëlua nga 22% në 2.3%.

Në sigurimin e pronës, vëllimi i primeve u rrit me 18%, duke arritur në 338.8 milionë euro. Linjat e sigurimeve motorike patën, në terma absolutë, kontributin më të lartë pozitiv në primet e shkruara bruto. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin motorik arriti në 734.5 milionë euro.

TURQIA

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, në fund të shtatorit 2024 tregu vendas i sigurimeve u rrit me 73.78% në vit duke arritur në 570.44 miliardë TRY, ose rreth 14.9 miliardë euro. E shprehur në monedhën evropiane, për shkak të nënçmimit me rreth 35% të lirës turke ndaj euros gjatë 12 muajve të fundit, ndryshimi i tregut ishte në rritje me 32.16% në terma vjetorë.

Spektori i sigurimit të Jetës u rrit me 75% në vit duke arritur në 69.27 miliardë TRY ose rreth 1.8 miliardë euro. Ndërsa primet në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 73.6% duke arritur në 501.16 miliardë TRY ose 13.1 miliardë euro. Megjithëse është ende jashtëzakonisht i lartë, ritmi i rritjes së tregut është ngadalësuar pak.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al